REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
15. 02. 2018
01 | 1101 | 248 | 6

# Republika e Kosovës
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura VI

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 8 dhe 9 shkurt 2018, pasi e shqyrtoi Raportin vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Audimit për vitin 2016 dhe Raportin e Pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016, mori këtë:

## VENDIM

Miratohet Raporti vjetor i Performancës së Zyrës Kombëtare të Audimit për vitin 2016 dhe Raporti i Pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Nr. 06-V-059

Prishtinë, 09.02.2018

Kryetari i Kuvendit:
për
**Kadri VESELI**

Vendimi dhe rekomandimet u dërgohen:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Zyrës Kombëtare të Audimit,
- Drejtorisë për mbështetje komisioneve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.

# Republika e Kosovës

**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**

***Kuvendi - Skupština - Assembly***

VI saziv

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 65 (9) Ustava Republike Kosova i člana 72 Poslovnika Skupštine , na plenarnoj sednici održanoj 8. i 9. februara 2018 godine, nakon razmatranja godišnjeg Izveštaja performancije Nacionalne kancelarije za reviziju za 2016 godinu i izveštaj finansijskih pregleda revizije za 2016 godinu, donela je sledeću :

## ODLUKU

Usvojiti godišnji Izveštaj performancije Nacionalne kancelarije za reviziju za 2016 godinu i Izveštaj finansijskih pregleda revizije za 2016 godinu, zajedno sa preporukama Komisije za nadgledanje javnih finansija.

Br. 06-V - 059

Priština, 09.02.2018

Predsednik Skupštine
**Kadri VESELI**

Odluku i preporuke dostaviti :

- Vladi Republike Kosova,
- Nacionalnoj kancelariji za reviziju,
- Direkciji za podršku parlamentarnim komisijama i
- Arhivi Skupštine .

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

06/353/Do-1811
05-12-2017

**Legjislatura VI**
**Sesioni Vjeshtor**

**PËR:** **Deputetët e Kuvendit**
**CC:** **Kryesinë e Kuvendit**

**NGA:** **Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

**LËNDA: Raport me rekomandime – në lidhje me Raportin vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe Raportin e Pasqyrave Financiare të audituara për vitin 2016**

**Datë: 16.11.2017**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të nenit 62, dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2017, e shqyrtoi Raportin vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016, me numër 06/242/Do-181, dhe Raportin e Pasqyrave Financiare të audituara për vitin 2016, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto:

**REKOMANDIME**

I. Të miratohet Raporti vjetor i Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si në vijim:

1. Zyra Kombëtare e Auditimit, gjatë auditimit për periudhën 2017-2018, të fokusohet në rekomandimet e dhëna nga auditori i brendshëm, se sa ato rekomandime po zbatohen nga menaxhmenti i institucioneve.

2. Zyra Kombëtare e Auditimit të rritë numrin e auditimieve të performancës, e veçanërisht për ndërmarrjet publike.

3. Gjatë auditimeve të ndërmjetme, Zyra Kombëtare e Auditimit të mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga viti paraprak.

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime, në seancë do ta paraqesë, deputeti Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

**ARSYETIM**

Në bazë të nenit 138, paragrafit 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në bazë të Ligjit Nr. 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm ka dorëzuar në Kuvend, Raportin Vjetor të Performancës rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ky raport përfshin ekstraktet relevante nga Pasqyrat Vjetore Financiare.

Pasqyrat vjetore financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2016, janë audituar nga Operatori ekonomik për auditim të jashtëm "Grant Thorton" (i emëruar nga Kuvendi për një periudhë të Auditimit prej tri vitesh). Sipas këtij auditimi, del se Pasqyrat vjetore financiare të prezantuara të Zyrës Kombëtare të Auditimit paraqesin një pamje të drejt dhe reale.

Për shqyrtimin e këtyre raporteve, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka ftuar edhe Auditorin e Përgjithshëm, z.Besnik Osmani, i cili para Komisionit ka bërë një prezantim të hollësishëm të aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
Vlen të theksohet se ZKA-ja, gjatë vitit 2016, ka përfunduar dhe ka publikuar këto raporte: Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës, për vitin 2015, 90 raporte të auditimit të rregullsisë dhe 5 raporte të auditimit të performancës. Numri i auditimeve të rregullsisë dhe të performancës është duke u rritur, ndërsa presim që ZKA-ja do të auditojë më shumë projekte të financuara nga donatorët dhe huamarrja në të ardhmen.

ZKA-ja ka raportuar për gjendjen e rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Zbatimi i rekomandimeve nga institucionet e nivelit qendror dhe nga institucionet e pavarura, është më i lartë në krahasim me vitin paraprak. Ndërsa zbatimi i rekomandimeve nga Komunat është më i ulët se në vitin paraprak. Nga 1177 rekomandimet e dhëna, të zbatuara janë 356, të adresuara në proces të zbatimit janë 418, ndërsa të paadresuara janë 403 rekomandime.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë, ftoj deputetët ta përkrahin Raportin e Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Me respekt,
Driton Selmanaj
Kryetar i Komisionit

06/353/Do-181
05-12-2017

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

**VI saziv**
**Jesenje zasedanje**

**Za: Poslanike Skupštine**
**CC: Predsedništvo Skupštine**

**Od: Komisije za nadgledanje javnih finansija**

**Predmet: Izveštaj sa preporukama u vezi godišnjeg izveštaja performansije Nacionalne kancelarije za reviziju za 2016 godinu i izveštaj revidiranih finansijskih pregleda za 2016 godinu**

**Datum: 16.11.2017**

Komisija za nadgledanje javnih finansija, na osnovu člana 62, 72 Poslovnika Skupštine, na sednici održanoj 16 novembra 2017 razmatrala je godišnji izveštaj performancije Nacionalne kancelarije za reviziju za 2016 godinu sa brojem 06/242/Do-181, kao i izveštaj finansijskih pregleda revidiranih za 2016 godinu i odlučila da Skupštini podnese sledeće :

**PREPORUKE**

I. Usvojiti godišnji izveštaj perfomancije Nacionalne kancelarije revizije za 2016 godinu, zajedno sa preporukama Komisije za nadgledanje javnih finansija , kao što sledi :

1. Nacionalna kancelarija revizije u toku revizije za period revizije 2017-2018, da se fokusira na date preporuke unutrašnjeg revizora, i da razmotri koliko se te preporuke sprovode od menadžera institucija .

2. Nacionalna kancelarija revizije da poveća broj performancije , posebno za javna preduzeća .

3. U toku revizije Nacionalna kancelarija revizije da nadgleda sprovođenje preporuka datih u prethodnoj godini .

II. Obrazloženje izveštaja sa preporukama na sednici podneće poslanik Driton Selmanaj, predsednik Komisije za nadgledanje javnih finansija.

**OBRAZLOŽENJE**

Na osnovu člana 138 stav 2 ustava Republike Kosova i na osnovu Zakona br. 05/L-055, o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji za reviziju Republike Kosova , Generalni revizor je dostavio Skupštini godišnji izveštaj perfomansije aktivnosti NKR. Ovaj izveštaj obuhvata relevantni ekstrakt godišnjih finansijskih pregleda.

Godišnji finansijski pregledi NKR za 2016 godinu revidirane su od ekonomskog operatora za spoljnu reviziju "Grant Thorton" ( imenovan od strane Skupštine za tro godišnji period revizije) . Prema reviziji proizilazi da finansijski godišnji pregled prezentiran od NKR predstavlja pravi i realni pregled .

Nakon razmatranja ovih izveštaja Komisija za nadgledanje javnih finansija pozvala je i Generalnog revizora Besnik Osmani, koji je pred komisijom detaljno prezentovao aktivnosti NKR. Treba istaći da u toku 2016 godine je završila i objavila sledeće izveštaje: godišnji izveštaj revizije budžeta Kosova (za 2015 godinu), 90 revidiranih izveštaja pravilnosti i 5 izveštaja revizije performancije. Broj revizije pravilnosti performancije se povećao , dok očekujemo da NKR revidira projekte finansiranih od donatora i dugova ubuduće.

NKR je izveštavala o stanju preporuka datih pre godinu dana. Sprovođenje preporuka od institucija na centralnom nivou i nezavisnih institucija je više u odnosu na prethodnu godinu . Dok sprovođenje preporuka od opština je niže u odnosu na prethodnu godinu. Od 1177 datih preporuka, sprovedeno je 356, adresirano u procesu sprovođenja je 418, dok ne adresiranih je 4032 preporuka .

Na osnovu gore navedenog, pozivam poslanike da podrže izveštaj performacnaije NKR za 2016 godinu zajedno sa preporukama Komisije za nadgledanje javnih finansija .

S poštovanjem,
Driton Selmanaj

________________

Predsednik Komisije